



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

KONTRAKTORI "LEDI MED" Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. Arben Alushaj, me Nr. Rexh. Biznesi, 71302261 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

FURNIZIMI ME FILMA TE RENTGENIT PËR QMF-në NË ISTOG

Nr. I prokurimit	633-018-7290-1-2-1/C147
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 057 - R / 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: FURNIZIMI FILMA PER RENGEN APARAT PËR QMF-në ISTOG

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i punëve për aktivitetin e prokurimit:

**FURNIZIMI ME FILMA PËR RENTGEN është ; 9.570,00 € dhe me fjalë:
/Nëntë mijë pesëqind e shtatëdhjetë euro/ €**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet
Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të

interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për: Autoritetin Kontraktues:

Për: Kontraktuesin:

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Arben Alushaj
Pozita:	Zyrtar Përgjigjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	25.10.2018	Data:	25.10.2018
Vu la		Vu la	